




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK  
 Nr. Prot. 01-3444/13  
 Nr. i faq. 02  
 Data 21.10.2013  
 Broj stranica  
 Datum  
 Nr. pages



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.10.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-2513/13, për z. Agim Peci – Drejtor ekzekutiv i Spitalit Rajonal të Mitrovicës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti nr. AKK-03-2513-13, i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, z. Agim Peci – Drejtor ekzekutiv në Spitalin Rajonal të Mitrovicës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Në rastin me numër protokoli AKK-03-2513/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Peci së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Peci është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë z. Peci në Agjenci ka sjellur informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-3278/13), në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte të ndërmarrja ORL "Lulja", për të ushtruar vet funksionin e tij zyrtar si Drejtor ekzekutiv në spitalin rajonal të Mitrovicës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

